

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
**ZYRA E SHEFIT TË MBËSHTETJES MËSIMORE**  
440 N broad st suite 210  
PHILADELPHIA PENNSYLVANNIA 19130

Cheryl J.Logan  
Shef

Telefon 215-400-4200  
Faks 215-400-4201

Të dashur pjestarë të Komunitetit të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias,  
Kam kënaqësinë t'ju informoj për mundësitë e nxënësve tanë gjatë stinës së verës. Këtë vit ne i kemi mundësitë e plota që të ofrojmë programe plotësuese dhe ato që shërbejnë për rifitimin e krediteve për nxënësit tanë. Më poshtë po japim detaje për programet e vlefshme gjatë verës për nxënësit:

**Shkrim-Leximi përmes Arteve**

Shkrim-Leximi përmes Arteve, ju ofrohet nxënësve në dhjetë shkolla, prej ku drejtori zgjedh nxënësit. Pjesëmarrësit do të përjetojnë një përvojë unike në aktivitetet, që pasurojnë aftësitë në shkrim-lexim bashkërisht me artet, për përmirësimin e aftësive në lexim, duke lidhur leximin më mirë me nxënësin. Programi do të jetë nga data 10 Korrik deri në 21 Korrik, nga E Hëna në të Premte, ora 8:30 Am-2:45 PM. Nxënësve do t'ju shërbehet mëngjes dhe drekë. Transporti nuk do të ofrohet.

**Zyra e Programeve Përgatitore për Kolegj & Profesion (OCCR)**

Zyra e Programeve Përgatitore për Kolegj & Profesion (OCCR) është në mbështetje të nxënësve të klasave të 9 dhe 10, të disa prej shkollave të mesme të Filadelfias. Këto programe janë strukturuar për nxitjen e kalimit të suksesshëm në shkollën e mesme, përfshirë pasurimin mësimor dhe përgatitjet pas përfundimit të shkollës së mesme

**Rifitimi i Krediteve për Nxënësit e Shkollave të Mesme**

Drejtorja Arsimore e Filadelfias do të ofrojë mundësi të kufizuara për rifitimin e krediteve për nxënësit këtë verë.

**KLASA e 12<sup>të</sup>** - Nxënësit mund të marrin klasa deri në dy kredite dhe/ose Projekt Shumë-Disiplinash dhe janë të gatshëm të diplomohen pas përfundimit të shkollës verore. Këto kurse përfitimi të krediteve ofrohen në shkollën e Mesme Benjamin Franklin.

**KLASA e 11<sup>të</sup>** - Nxënësit mund të marrin klasa me deri në dy kredite në lëmin e Anglishtes, Historisë, Matematikës, Shkencës, ose Spanjishtes. Këto kurse të rifitimit të krediteve ofrohen për nxënësit e klasës së 11<sup>të</sup> në shkollën e Mesme Benjamin Franklin.

**Programi Veror për Fëmijët dhe të Rinjtë Imigrantë (ICY) 2017**

Programi veror ICY është për Nxënësit që Mësojnë Anglisht (ELLs), dhe që aktualisht janë në klasat 4 deri 7 (ata që kalojnë në klasat e 5ta- 8ta), të cilët janë të rinj në USA (më pak se tre vite). Programi i paradites do të përfshijë mësim në Anglisht dhe matematikë, që mësohen nga mësues të Drejtorisë Arsimore të Filadelfias. Programi i pasdites përfshin mësim në arte, muzikë dhe teatër. Këto klasa mundësohen nga organizatat komunitare.

**DREJTORIA ARSIMORE E FILADELFIAS**  
**ZYRA E SHEFIT TË MBËSHTETJES MËSIMORE**  
440 N broad st suite 210  
PHILADELPHIA PENNSYLVANNIA 19130

**Cheryl J.Logan**  
Shef

**Telefon 215-400-4200**  
**Faks 215-400-4201**

**Pedana Verore**

Pedana Verore ofron një program 5 javor intensiv në shkrim-lexim për nxënësit aktualë të nivelit K-4 dhe familjet e tyre në shtatë shkolla. Programi synon të zvogëlojë diferencën në lexim duke angazhuar mësuesit, familjarët, duke vënë objektiva dhe ofruar stimuj, që zvogëlojnë humbjet gjatë verës. Komponentët e programit përfshijnë vizita në shtëpi, mësimë në shkrim-lexim,seminare familjare dhe bonuse mësimore për nxënësit.

**Punësimi Veror i (Edukimi Tekniko-Profesional) CTE**

Drejtorja Arsimore e Filadelfias nëpërmjet Zyrës së Edukimit Tekniko-Profesional do të ofrojë mundësi punësimi dhe kualifikimi gjatë verës për nxënësit e shkollës së mesme të moshës 14-18 vjeç. Programi Veror i Punësimit Tekniko-Profesional (CTE) , është një program novativ, i cili i ofrohet nxënësve të CTE, që ndjekin aktualisht Shkollat Publike të Drejtorisë së Filadelfias mundësinë të përfitojnë përvojë të çmuar në punë dhe të zhvillojnë aftësitë, që mund të përdoren në vendin e punës. Programi i punësimit veror është një zgjatim i kurrikulës mësimore që nxënësit mësojnë gjatë vitit mësimor. Kjo mundësi i lejon nxënësit të marrin një përvojë reale të punës, që nuk mund të përfitohet në klasat e shkollës.

**Programet Jashtë Shkollore (OST)**

Drejtorja Arsimore e Fladelfias, gjatë vitit shkollor zhvillon shumë programe jashtëshkollore, të cilat operohen nga organizata jo fitimprurëse. Në muajt e verës shumica e këtyre programeve ofrohen në kampet verore me kohëzgjatje gjashtë-javore, çdo ditë të javës (E Hënë e Premte). Këto programe zakonisht u shërbejnë nxënësve të shkollave të tyre.

Në vazhdim, të gjitha pyetjet në lidhje me programet verore, duhet të adresohen tek drejtuesit e shkollave të tyre.

Ju faleminderit dhe shpresojmë t'u shërbejmë sa më mirë nxënësve të Filadelfias këtë verë.

Sinqerisht

**Cheryl J.Logan**

Shef në Zyrën e Mbështetjes Mësimore